Kronikë

Lezhë/ Përshtatën garazhin për prodhim narkotikësh, në pranga 3 të rinj! Sekuestrohen doza kanabisi, 1 armë zjarri dhe 2 radio marrëse-dhënëse

Policia e Lezhës ka zbuluar një garazh që ishte përshtatur për prodhimin e lëndëve narkotike. Në pranga kanë rënë 3 veta, si dhe janë sekuestruar 70 doza kanabis, 1 armë pistoletë me krehër dhe 2 radio marrëse-dhënëse.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
11 Tetor, 14.09 | **Përditesimi: 11 Tetor, 14:23**

Share

LEZHË - Policia e Lezhës ka zbuluar një garazh që ishte përshtatur për prodhimin e lëndëve narkotike. Në pranga kanë rënë 3 veta, si dhe janë sekuestruar 70 doza kanabis, 1 armë pistoletë me krehër dhe 2 radio marrëse-dhënëse.

U arrestuan: Rigers Marku, Reneo Përgjjini, Erisolo Marku

'Si rezultat i hetimeve të kryera nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve i DVP Lezhë, për një rast të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, u finalizua në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", operacioni policor i koduar "Befasia". Gjatë këtij operacioni u arrestuan në flagrancë shtetasit:

LEXO EDHE:
Qendra e emigrantëve në Gjadër/ Ministri i Brendshëm italian: Hapet javën tjetër, nuk do ketë prerje shiriti! Transferohen 400 të parët

-E. M., 24 vjeç, banues në Lezhë, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim;

-R. P., 24 vjeç, banues në fshatin Manati, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim;

-R. M., 24 vjeç, banues në Lezhë, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", kryer në bashkëpunim dhe "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve, shpërthyese dhe municionit".

Nga veprimet hetimore dyshohet se shtetasi E. M. e kishte përshtatur garazhin e tij, për veprimtarinë kriminale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike.

Gjatë kontrollit në ambientet e garazhit u gjetën 70 doza të lëndës së dyshuar narkotike cannabis sativa, 1 armë zjarri pistoletë me krehër me municion luftarak, që dyshohet se e posedonte shtetasi R. M., dhe 2 radio marrëse-dhënëse, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, bashkë me 3 celularë dhe 1 automjet.

Vijojnë hetimet për dokumentimin e plotë të këtyre veprimtarive kriminale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.'

Lajmi ne perditesim...

G.K/r.k./Shqiptarja.com

TAG: kanabis Lezhe

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Shqipëria hap negociatat me BE për kapitullin 1, kur do ndodhë integrimi?

Brenda 2030 | Pas 2030 | Nuk e di

Lajme të tjera

Kamëz/ Shpërndanin kanabis, arrestohen 2 të rinj! Një i tretë në pranga pasi theu arrestin e shtëpisë
12 Tetor, 14:05

Reportazh/ Vetëm pak ditë para mbërritjes së emigrantëve, 'Report TV' sjell pamjet brenda kampit të Gjadrit! Dhoma e gjykimit dhe burgu!
Elvis Hila
11 Tetor, 17:18

Gati qendrat e emigrantëve në Lezhë! Brenda pak ditësh vijnë emigrantët e parë! Përfaqësuesit e qeverisë italiane inspektojnë kampet (VIDEO)
11 Tetor, 10:51

Tiranë/ U kap me 2.1 kg kanabis, arrestohet në flagrancë 31- vjeçari
11 Tetor, 09:25

Lezhë/ Dalja nga shtrati e kanalit kullues la pas dy ura të dëmtuara në Fishtë, dëme të vogla në bujqësi
Elvis Hila
10 Tetor, 14:02

Moti i keq/ Reshje intensive shiu në Lezhë, vërshojnë përrenjtë në zonën e Zadrimës! Disa banesa të përmbytura, evakuohet një familje (VIDEO)
9 Tetor, 21:53

Dëmet/ Zjarri i korrikut shkrumboi 50 hektarë me pisha në Shëngjin! Specialisti: Të hartohet program për ringritjen e pyjeve
Elvis Hila
9 Tetor, 15:44

Atentati ndaj Agron Pukës para shkollës në Lezhë, arrestohet Amarildo Kola! Nën hetim 6 personat që ishin me të në lokal
9 Tetor, 14:17

Nesër reshje në Shkodër e Lezhë, tre ministra dakordësojnë masat parandaluese me kryebashkiakët: Inspektoni hidrovoret dhe pastroni kanalet
8 Tetor, 21:18

U kap në fermë kanabisi, shqiptari: Po punoj për të shlyer borxhin 10 mijë paund ndaj atyre që më sollën në Angli
8 Tetor, 19:32

Lezhë/ Merr flakë magazina, shërbente si bazë ushqimore për bagëtitë, vetëm dëme materiale
8 Tetor, 13:03

Aksidenti në Lezhë/ Policja përplasi për vdekje kalimtarin, dyshohet se viktima i preu rrugën makinës
Elvis Hila
7 Tetor, 14:30

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje